

LEDIA DUSHKU

**FIGURA E GJERGJ KASTRIOTIT - SKËNDERBEUT
DHE PERCEPTIMI PËR TURQIT OSMANË NË DISKURSION
E QEVERISË SË PËRKOQSHME TË VLORËS***

Përdorimi në diskursin publik i veprimtarisë së figurave që kanë shenjuar periudha të rëndësishme të historisë, është pjesë e qenësishme në procesin e formësimit të kujtesës kolektive, si dhe atij të ngjizjes së identitetit dhe krijimit të shtetit kombëtar. Figura e Gjergj Kastriotit-Skënderbeut, Heroit të vetëm Kombëtar të shqiptarëve është një e tillë, me ndikim thelbësor në proceset identitare dhe shtetformuese. Veçanërisht që prej fundit të shek. XIX, janë veprimtarët e Rilindjes Kombëtare ata, që në kuadrin e procesit të inxhinierisë identitare e mitizuan figurën e Skënderbeut, duke u përpjekur të rikrijojnë kujtesën kolektive veçanërisht mbi luftërat e tij kundër osmanëve, me synimin e qartë dykahësh, të formësimit dhe rritjes së vetëdijes kombëtare dhe të pasqyrimin të kontributit mbrojtës që shqiptarët i kishin dhënë qytetërimit evropian. Ky kontribut, veçanërisht kur i drejtohej opinionit ndërkombëtar, nënkuptonte edhe procesin e kundërt, borxhin që Evropa do të duhej t'i kthente shqiptarëve, duke i ndihmuar tanimë në procesin e mëvetësisë nga Perandoria Osmane.

Në këtë aspekt, Naim Frashëri, figurë qendrore e Rilindjes Kombëtare Shqiptare, në poemën *Istori' e Skënderbeut (1898)*, tërhiqte vëmendjen, se Evropa e shek. XV ishte e paafte për të mbrojtur veten dhe, shpëtimi prej turqve ndodhi vetëm falë luftës së shqiptarëve me në krye Skënderbeun. Nëpërmjet përdorimit të ndajfoljes mohuese, kontributi i Skënderbeut si mbrojtësi i vetëm i Evropës së paafte, mbivlerësohej duke marrë doza mitike. Në vargjet 265-268, të këngës XIV të poemës, Naimi i tregonte lexuesit se:

* Kumesë e mbajtur në Konferencën Ndërkombëtare Albanologjike, "Gjergj Kastrioti Skënderbeu, koha në të cilën jetoi dhe gjurmët e tij në histori", organizuar nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Akademia e Shkencave dhe Arteve e Kosovës, Akademia e Studimeve Albanologjike dhe Universiteti i Tiranës, më 1-2 nëntor 2018.

“Po të mos ishte Shqipëria
Gjith’ Evropën e verbuar
E kish marrë Tyrqija
Nuk i kishte shpëtuar”.¹

Në këtë linjë qëndron edhe i vëllai, Samiu. Në veprën *Shqipëria ç’ka qënë, ç’është e ç’do të bëhet? Mendime për shpëtim të Mëmëdheut nga reziket që e kanë rethuarë*, botuar për të parën herë në Bukuresht, një vit më vonë, e konsideruar si manifesti i Rilindjes Kombëtare Shqiptare, në lidhje me qëndresën e shqiptarëve karshi osmanëve, ai shprehej:

“Dyzet e kaqë vjet (40 vjet) qëndroi kështu Skënderbeu me Shqipëtarët duke var’ e duke handakosur armiqtë; ... Gjithë pushtetat’ e Evropës, që ishin atëherë, kishin shpresë te Skënderbeu. E prisnin shpëtimin’ e Evropës nga Shqipëtarët...”.²

Në kontekstin e mësipërm, figura dhe aktiviteti luftarak i Heroit Kombëtar inkuadrohej jo rastësisht në një kornizë më të gjerë, që kishte të bënte me procesin e gjatë e të vazhdueshëm, të përshkruar nga sociologu Enis Sulstarova, si procesi i ikjes apo arratisjes nga Lindja dhe rendjes drejt Perëndimit.³ Vetëm Skënderbeu që shikonte nga Evropa dhe jo nga Azia u ngrit kundër “egërsisë aziatike”, vijonte ligjërimin e tij, Sami Frashëri.

Si ligjërim modernizues i elitave intelektuale e politike shqiptare, ligjërimi i rilindësve bëri qasje të vetën dallimin Lindje/Perëndim dhe konstitui kundërvënien e racës shqiptaro-evropiane me atë turko-aziatike, ngjashëm me nacionalizmat e krishterë të Ballkanit.⁴ Të paktën që prej gjysmës së dytë të shek. XIX, turqit osmanë përshkruheshin si të kundërtit e shqiptarëve, me cilësi të ulëta, që shqiptarët nuk i kishin dhe nuk donin t’i kishin. Ata ishin aziatikë, barbarë, të egër, shkatërrimtarë,

¹ Enis Sulstarova, *Arratisje nga Lindja. Orientalizmi shqiptar nga Naimi te Kadareja*, botim i tretë i ripunuar, Tiranë: West Print, 2013, f. 70.

² Sami Frashëri, *Shqipëria ç’ka qënë, ç’është e ç’do të bëhet? Mendime për shpëtim të mëmëdheut nga reziket që e kanë rethuarë*, (botuar për të parën herë në Bukuresht, më 1899), Tiranë: Naim Frashëri, 1962, f. 25.

³ Enis Sulstarova shprehet se “Arratisja e shqiptarëve prej “Lindjes” dhe rendja drejt “Perëndimit” ka shërbyer si një horizont përfytyrues, si një shtrat rregullues i pikëpamjeve të elitave politike dhe intelektuale për Shqipërinë moderne dhe identitetin evropian të kombit shqiptar. Si kundërtezë e asaj që përfaqësonte “Perëndimi”, si “tjetri” apo mungesa e tij, qëndronte “Lindja”, E. Sulstarova, *Arratisje nga Lindja...*, f. 26.

⁴ *Po aty*, f. 38.

fanatikë e të prapambetur, pa asgjë të përbashkët me shqiptarët, të cilët nuk vinin nga Azia. Shqiptarët ishin kombi më i vjetër i Evropës, që me qëndresën e identifikuar me emrin e Gjergj Kastriotit-Skënderbeut, ishin flijuar për të.

Figura e Skënderbeut dhe perceptimi për turqit osmanë në ligjërimin e jashtëm dhe të brendshëm të qeverisë së Ismail Qemal Vlorës

Nëse rilindësit hodhën piketat kryesore në procesin e inxhinierisë identitare, Shpallja e Pavarësisë dhe ekzistenca e shtetit i krijoi elitave politike e intelektuale shansin për të vënë në jetë eksperimentin e evropianizimit të Shqipërisë si fazë fundore, që do të përmbyllte me sukses edhe procesin e inxhinierisë identitare të shqiptarët. Modernizimi i shtetit, do të duhej të kalonte nëpër një proces të gjatë deosmanizimi, me synim të qartë shmangien e etiketimit që për shkak të popullsisë në shumicë myslimane dhe bashkëjetesës së gjatë si pjesë e Perandorisë Osmane, mund t'i bëhej Shqipërisë si një "shtet mysliman", që nuk e kishte vendin në Evropë, por i përkiste Lindjes.

"Tash ç'udhë të qeverimit Shqipëria, si mbretërië do të mbajë? Atë të Turqiës a po atë të shteteve Evropiane? Jemi të bindur krejt që Shqipëria do të mbajë të dytën, d.m.th. atë të shteteve evropiane".⁵

Kjo ishte pyetja që i bëhej lexuesit të gazetës *Përlindja e Shqipëniës*, organi zyrtar i Qeverisë së Përkohshme të Vlorës dhe përgjigjja që i jepej për drejtimin e Shqipërisë pas Shpalljes së Pavarësisë, më 28 nëntor 1912. Ligjërimi i elitës politike dhe intelektuale shqiptare fill pas këtij momenti, në vijimësi të Rilindjes Kombëtare zhvillohet në kuadrin e procesit të modernizimit të shtetit sipas modelit të shteteve evropiane. I inkuadruar në këtë proces vijon të jetë edhe diskursi që ka të bëjë me figurën e Gjergj Kastriotit-Skënderbeut dhe perceptimi për turqit osmanë. Sakaq evidentohet një qasje dalluese në mënyrën se si këta trajtohen në ligjërimin e jashtëm dhe atë të brendshëm* të Qeverisë së Përkohshme të Vlorës.

⁵ Gjon Bud, "Propagandat e masat e Qeverriës", në *Përlindja e Shqipëniës*, Vlorë, 27 gusht 1913, f. 2-3.

* Termi "ligjërim i jashtëm" në këtë prezantim përdoret në kuptimin e ligjërimit që Qeveria e Përkohshme shqiptare dhe kryetari i saj Ismail Qemal Vlora përdorte jashtë

Perceptimi për turqit osmanë nuk shfaqej unik në ligjërimin e Qeverisë së Përkohshme të Vlorës. Ai ishte fluid, duke marrë tone të ndryshme në varësi të qëndrimit që Fuqitë e Mëdha mbanin ndaj çështjes shqiptare në Konferencën e Ambasadorëve në Londër. Fluide shfaqej edhe pesha që ligjërimi i brendshëm dhe ai i jashtëm zinte në esencën e përgjithshme ligjëruese të qeverisë shqiptare. Prej dhjetorit 1912 deri në maj 1913, kur Fuqitë e Mëdha në Londër i qëndruan vendimit për autonominë e Shqipërisë nën suzerenitetin e Sulltanit, vëmendjen kryesore e mori ligjërimi i jashtëm. Qëllimi final i Qeverisë së Vlorës ishte bindja e Të Mëdhenjve se shqiptarët e meritonin shtetin e tyre të pavarur. Në maj, Fuqitë e Mëdha ndryshuan qëndrim, duke rënë dakord të ndërprinin çdo lidhje të Perandorisë Osmane me shtetin shqiptar dhe të merrnin vetë në dorë të ardhmen e tij. Vendimin përfundimtar ata e shprehën më 29 korrik 1913. Fuqitë e Mëdha njohën formimin e shtetin shqiptar “si principatë autonome, sovrane dhe të trashëgueshme, nën garancinë e gjashtë Fuqive të Mëdha...”, me një princ të huaj në krye dhe ruajtën ndikimin e tyre në Shqipëri nëpërmjet krijimit të Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit.⁶ Gjatë kësaj periudhe (maj-korrik 1913) në ligjërimin e Qeverisë së Përkohshme shqiptare vihet re një baraspeshë në raportin midis ligjërimin të jashtëm dhe atij të brendshëm. Duke filluar nga gushti i 1913-s peshën kryesore e mori ligjërimi i brendshëm.

Tipare të ligjërimin të jashtëm

Në ligjërimin e jashtëm perceptimi për turqit osmanë ruante ngjyra diplomatike dhe institucionale, karakteristikë kjo dalluese edhe në të folurën e mëhershme të kryetarit të saj, Ismail Qemal Vlorës.⁷ Si pjesë e

shtetit, në raport me Fuqitë e Mëdha dhe Perandorinë Osmane. Ndërsa “ligjërimin i brendshëm” ka parasysh diskursin e përdorur brenda shtetit, midis vetë shqiptarëve.

⁶ Për një trajtim të thelluar të ecurisë së çështjes shqiptare në Konferencën e Ambasadorëve në Londër dhe vendimet e marra në lidhje me të përgjatë harkut kohor dhjetor 1912-korrik 1913 shih: Arben Puto, *Shqipëria Politike, 1912-1939*, Tiranë: Toena, 2009, f. 53-84; Paskal Milo, *Politika e jashtme e Shqipërisë*, vëll. I (1912-1939), Tiranë: Toena, 2013, 79-138; *Historia e shqiptarëve gjatë shekullit XX*, vëll. I, Akademia e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë, Tiranë: Kristalina-KH, 2017, f. 176-195.

⁷ Ismail Qemal Vlora personifikonte shtetarin me mendime përparimtare e liberale, me aftësi të rralla diplomatike, të cilin regjimi osman ishte munduar ta bënte të padëmshëm, jo vetëm duke e mbajtur larg vendlindjes, por edhe duke i ofruar funksione të larta në piramidën shtetërore osmane, të cilat i shkolin për shtat

elitës politike e diplomatike osmane, me lidhje të vazhdueshme dhe intensive me shtetarë perëndimorë, esenca ligjëruese në publicistikën e I. Qemalit shfaqte tone të moderuara, përgjithësisht të ftohta dhe asnjëse. Ndonëse përbalja mes Lindjes dhe Perëndimit ishte e pranishme, ajo artikulohej pa ngjyresa fetare dhe pa prezencën e notave të ashpra. Sa i përket Shqipërisë, orientimi nga Perëndimi nuk artikulohej hapur në ligjërimin e tij, por nënkuptohej me ëndrrën e saj, rendjen drejt “idealit të lirisë dhe të pavarësisë”. Sikurse për Perandorinë Osmane, edhe përparimi i saj duhej bërë me mbështetjen e Evropës.

Perceptimi për turqit osmanë në ligjërimin e Ismail Qemalit, përgjithësisht i përgjigjet formatit të një diplomati të kujdesshëm dhe me përvojë, pa përdorur epitete fyese, si barbarë, të egër, apo të pacivilizuar. Vetëm në një rast kemi mundur të gjejmë një prononcim negativ, i pasqyruar në gazetën *Shkupi*, të datës 2 qershor 1912. Aty turku konsiderohej “barbar”, një racë që nuk “mer përparim e qytetni”.⁸

Pas Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë, në ligjërimin e jashtëm të Ismail Qemal Vlorës dhe qeverisë që ai drejtonte nuk anashkalohej gjuha diplomatike dhe ajo institucionale. Kujdesi për të mbajtur një qëndrim të ekuilibruar me Perandorinë Osmane ishte tipar dallues i tij. Në memorandumun e Qeverisë së Përkohshme të Vlorës dërguar Konferencës së Ambasadorëve në Londër, më 2 janar 1913,⁹ fakti se Shqipëria “nuk ka qenë në gjendje të ndjekë kombet perëndimore në zhvillimin e tyre të

përgatitjes së tij. Nga nëpunës në Zyrën Juridike të Këshillit të Shtetit apo sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Jashtme Osmane, I. Qemali u emërua kryetar i bashkisë së Janinës, për të vazhduar në vitet në vijim si guvernator i vilajetit të Bejrutit e atij të Tripolit. I cilësuar si antiosman, por jo antiperandor, Ismail Qemali në vazhdimësi kishte kundërshtuar politikat centralizuese të Portës, duke acaruar herë pas here marrëdhëniet me të. Partizan i reformave në jetën shtetërore turke, që kishte mbështetur hapur reformatoren radikal Mid’hat Pashën, atin e Kushtetutës Osmane të vitit 1876. Me të, I. Qemali ndante edhe simpatinë për Britaninë e Madhe dhe Francën. Pas Revolucionit të Turqve të Rinj dhe rivendosjes së Kushtetutës, në korrik 1908, drejtoi Partinë Liberale Osmane (AHRAR). Për më shumë shih: Ledia Dushku, *Kur historia ndau dy popuj fqinj. Shqipëria dhe Greqia (1912-1914)*, QSA, Instituti i Historisë, Tiranë: Kristalina-KH, 2012, f. 59-65.

⁸ “Ismail Qemali tha kto fjal” në *Shkupi*, Shkup, 2 juine 1912.

⁹ *Qeveria e Përkohshme e Vlorës dhe veprimtaria e saj (28 nëntor 1912-22 janar 1914)*, botim i Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave Shtetërore të RPSH, Tiranë: Mihal Duri, 1963, f. 98-100. Memorandumi i delegatëve të Qeverisë së Përkohshme të Vlorës dërguar Konferencës së Ambasadorëve dhe Fuqive të Mëdha në Londër, 2 janar 1913.

mrekulluarshëm në rrugën e përparimit dhe të qytetërimit”, paraqitej qartë që në faqen e parë, por shkaqet e kësaj prapambetjeje nuk artikuloheshin haptazi. Ato rrumbullakoseshin me shprehje të tilla si: “kushtet jo të përshtatshme që e kanë rrethuar” apo “ka vuajtur shumë nën zgjedhën e të huajve”, pa i akuzuar turqit osmanë si shkaktarë të prapambetjes. Duke dashur të evitonte acarimin me to, në kushtet kur Fuqitë e Mëdha kishin vendosur që Shqipëria të ishte autonome, në memorandum ishte shmangur me kujdes përdorimi i figurës së Skënderbeut dhe i luftërave të tij, por pa anashkaluar përkufizimin e identitetit kombëtar shqiptar si i kundërt me Lindjen dhe trajtimin e shqiptarëve si të ndryshëm nga turqit, pavarësisht se në shumicë ata ishin myslimanë.

Tipare të ligjërimit të brendshëm

Në raportet brenda shtetit, ligjërimi i Qeverisë së Përkohshme të Vlorës mori përsipër misionin qytetërues ndaj shoqërisë, pakicave apo kategorive të caktuara periferike (fshatarë, malësorë etj.), perceptimi dhe mënyra e jetesës së të cilave nuk i përshtatej vizionit që elita, në këtë rast qeveria, kishte mbi shtetin dhe shoqërinë. Bëhet fjalë për atë që studiuesi i qytetërimeve, Ferdinand Braudel, e konsideron si “punë e vetes mbi veten”.¹⁰ “Shqipëria u bë po duhen bërë shqiptarët”, shprehej Kristo Floqi në shkrimin e tij te *Përlindja e Shqipëniës* e datës 20 gusht 1913.¹¹

Edhe pse pjesa dërrmuese e intelektualëve shqiptarë të kohës ishin pjesë e kontekstit osman të reformimit të shtetit, ata u përpoqën në vazhdimësi të ndaheshin nga e kaluara, duke i diferencuar sa më shumë shqiptarët nga turqit osmanë, pavarësisht se në shumicë ata i përkisnin të njëjtës fe. Argumentimi, që përdorej në këtë rast, ishte i njëjtë me atë që kishin përdorur më herët rilindësit shqiptarë. Ai lidhej me qenien e turqve osmanë një popull aziatik, për të cilin, konsideroheshin të huaja përparimi, dituria dhe qytetërimi. Në antitezë me ta, kombi shqiptar ishte evropian, në rrënjë dhe në thelb të tij. Si i tillë, ai mund të përparonte me shpejtësi “si të gjithë kombet e qytetëruara dhe të liruara midis shteteve të Evropës”, veçanërisht tashmë me shkëputjen nga Perandoria Osmane. Në dallim nga ligjërimi i jashtëm, gjuha e përdorur ishte e drejtpërdrejtë dhe

¹⁰ Ferdinand Braudel, *Gramatikë e qytetërimeve*, përktheu Fatos Kongoli, Tiranë: Instituti i Dialogut dhe Komunikimit, 2005, f. 66.

¹¹ Kristo Floqi “Gjyqësia në Shqipërië”, *Përlindja e Shqipëniës*, Vlorë, 20 gusht 1913, f. 3.

pa doreza diplomatike. Sundimi i gjatë osman cilësohej hapur si shkaku kryesor i prapambetjes së shqiptarëve dhe i largësisë së tyre nga qytetërimi evropian.¹² Perandoria Osmane ishte e keqja, barbarja, aziatikja, tiranikja që i kishte mbajtur shqiptarët në padije, në varfëri, mjerim e prapambetje.¹³

Dallimi midis dy Botëve, Lindjes dhe Perëndimit shfaqej qartë në faqet e *Përlindjes së Shqipëniës*. Në shkrimin e publicistit Dionis Karbonara, në mënyrë figurative, ato paraqiteshin si dy mbretëresha, dukshëm me tipare dhe cilësi të ndryshme. E para që personifikonte Perëndimin, “...me sytë ngjyrë deti të zbeta, qe ... kishte, në këmbët e saj të bardha, sandale prej mushku e prej vjollcash, e veshurë me një rrobë të qendisurë me yjëza dhe mbi krye një kurorë të ërgjentë quhesh Shpresë”, ndërsa tjetra, pra Lindja “... me sytë të zinj porsin nata, gjithnjë të lagurë prej lotëve dhe kraharorin e fryrë nga pserëtimet, ishte veshurë parregullsisht me një rrobë të zjarrtë”.¹⁴

¹² Sundimi i gjatë osman, në vazhdimësi, do të konsiderohet si një nga arsyet e prapambetjes së shoqërisë shqiptare, në ligjërimin e elitës politike. 12 vjet pas Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë, Mid’hat Frashëri (Lumo Skëndo), në broshurën e tij “Plagët tona. Çë na mungon? Çë duhet të kemi?”, përpiquej të evidentonte plagët e shoqërisë shqiptare dhe njëkohësisht të zbulonte ilaçin që do t’i shëronte ato. Qartazi, në pjesën e dytë të studimit, të titulluar “Të metat tona. Të veprojmë”, ai e përcaktonte sundimin e gjatë osman si një nga arsyet e prapambetjes së shqiptarëve. Përmes figuracionit letrar, ai sundim i paraqitej lexuesit, si një hije e zezë, si një gur i rëndë që kishte rënduar mbi mendjen dhe vetëdijen e shqiptarëve, si një kohë e errët “që ment na shoj çdo ndjenjë njerëzие, çdo cilësi njeriu të ndershmë”. “Sundimi pesë shekullor i Tyrqisë, një sundim nga më të zezët që kanë njohurë historit e botës, analizonte Mid’hat Frashëri, na ka shtuar të metat e vjetra, duke na pakësuar virtytet: Tyrku na mësoj edhe një herë akoma ma përtacë, më të harbuarë; na mësoj që të mos e duamë ligjin, të mos e njohim, të mos i bindemi. Na stërviti edhe një herë më tepër që të rrojmë dhe jo me diersën e ballit tënë....Edukata që muarmë në oxhakët e Jençerëve na bëri të jemi të këqinj dhe të pa drejtë kundër vallezërvet tanë më të dobët, të humbasim çdo ndjenjë dhe virtyt kombi, të gjendemi si fis i egrë, armik dhe i përçarë me njëri-tjatin, pa asnjë farë bashkimi, indiferent në përparim, të mërguarë prej çdo lumtërije materiale, me qënë se të larguarë nga bashkimi, pa kolaborim dhe pa solidaritet...” Lumo Skëndo, *Plagët tona. Çë na mungon? Çë duhet të kemi*, Tiranë: Mbrothësia, 1924, f. 13-15.

¹³ Grigor Cilka, “Gjindja e Shqipëniës”, në *Përlindja e Shqipëniës*, Vlorë, 11 Kallënduar 1914, f. 2.

¹⁴ Dionis Karbonara, “Të dy Mbretëreshat”, në *po aty*, Vlorë, 6 gusht 1913, f. 3.

Figura e Skënderbeut si pjesë e ligjërimit të brendshëm të Qeverisë së Përkohshme të Vlorës

Më 28 nëntor 1912, në momentin e vetëvendosjes së shqiptarëve dhe ngritjes së flamurit kombëtar, figura e Gjergj Kastriotit mbarnte sa motivimin për aktin e lartë po aq sa edhe mesazhin e ringjalljes së shtetit shqiptar. “Flamuri lavdiplotë”, të cilin Ismail Qemal Vlora e personifikonte me emrin e Skënderbeut, ishte ngritur mes brohoritjeve të shumta, atë pasdite të së enjtes së fundit të vjeshtës së tretë. Në përjetimet e tij, Ati Themelues e konsideronte një çast të paharrueshëm:

“Ndjeva duart si më dridheshin emocionesh shprese e krenarie, kur po ngulitja në ballkonin e shtëpisë sime të hershme flamurin e Sovranit të fundit kombëtar të Shqipërisë. Dukej sikur shpirti i heroit të pavdekshëm ndriti atë çast si një dritë e shenjtë përmbi kokat e njerëzve”.¹⁵

Për sociologun Enis Sulstarova ndjesia se shpirti i Skënderbeut ishte i pranishëm në mesin e delegatëve dhe të popullit të Vlorës, mund të kuptohet si një shembull të asaj që filozofi dhe historiani Hans Blumenberg e quan *präfiguration / parapërfytyrim*. Ideja e parapërfytyrimit rrjedh nga tradita biblike, sipas së cilës ndodhitë e përshkruara në Dhiatën e Vjetër duket sikur parathënë ngjarjet që do të ndodhin më vonë dhe që janë përshkruar në Dhiatën e Re. Blumenbergu në studimin e tij për rolin e miteve në politikë, shkruan se parapërfytyrimi është një mënyrë për t’i dhënë legjitimitet një vendimi, me anë të ndjelljes së një ngjarjeje historike, që duket sikur i paraprin atij. Risia, hovi drejt së panjohurës, vijon arsyetimin Sulstarova, paraqitet si një përsëritje e një ngjarjeje, apo vijim i një procesi të nisur kohë më parë. Ajo që do të vijë është tashmë e paracaktuar. Historia pajiset kështu me një rregullsi të brendshme dhe nuk duket si rrënimtare tekanoze e projekteve njerëzore. Në këtë kontekst, 28 nëntori i vitit 1912 ishte parathënë shumë kohë më parë, më 28 nëntor 1443. Flamuri i Shqipërisë së lirë ishte po ai që kishte ngritur Gjergj Kastrioti në Krujë, çka e bënte këtë të fundit “të gjallë” në mesin e shqiptarëve të mbledhur në Vlorë.¹⁶

¹⁵ Ismail Qemali, *Kujtime*, Tiranë: Toena, 2009, f. 418.

¹⁶ *Po aty*.

Njëkohësisht në ligjërimin e brendshëm, figura e Gjergj Kastriotit-Skënderbeut risillej në vëmendje, edhe në kuadrin e përballjes mes dy botëve dhe paraqitjes së shqiptarëve si të kundërt të turqve osmanë. Veprimtaria e Gjergj Kastriotit, e fokusuar te mbrojtja e Evropës në momentin e saj më të vështirë, është një tjetër aspekt, që zë vend pa drojë në ligjërimin e kryetarit të Qeverisë së Përkohshme. Në fjalimin historik të 28 nëntorit 1912, me patos të pazakontë për të, por të kërkuar nga momenti, ai e konsideronte Shqipërinë e periudhës së Skënderbeut si porta e hekurt e Evropës. Ja si i drejtohej Ismail Qemal Vlora, shqiptarëve të ekzaltuar:

“Porsi ëndër më duket ky ndryshim i madh i vendit t’ onë që hoqi e voi të zezat e ullirit 500 vjet me radhë ndënë sundimin turk, ... kjo Shqipëri që dikur shkëlqente nga trimëria e pashoqe e bijve të saj; kjo Shqipëri që kur i kërcënohej rreziku Evropës nga pushtimet e Turqisë, ndënë kryetrimin e pavdekur të saj, Skënderbejnë, u bë porta e hekurtë kundra sulmeve më të tërbuara të sulltanëve më t’ egër që ka pasë Turqia”.¹⁷

Në faqet e *Përlindjes së Shqipëniës*, shkrimet apo poezitë që i kushtohen Gjergj Kastriotit Skënderbeut i përkasin autorëve të besimeve të ndryshme fetare. Si pjesë e diskursit të tyre, kryesisht përdorej emri Skënderbe dhe jo Gjergj Kastrioti. Vetëm në një rast, identifikuar në shkrimin e Kostë Çekrezit ku përdoreshin të dyja, në të gjithë artikujt e tjerë, termi mbizotërues është ai i Skënderbeut. Shpeshherë emri i tij shkruhej me germa kapitale, duke e dalluar nga të tjerët. Në kuadrin e një analize që synon të zbulojë arsyet e këtij përdorimi, si konstatim i parë mund të themi se në kujtesën e shqiptarëve emri “Skënderbe” personifikonte liderin, ushtarakun, shtetarin dhe përbashkuesin në aspektin etnik, përtej larmisë fetare. Ai e tejkalonte kështu figurën e Gjergjit-fëmijë, i larguar që herët nga vendlindja, për të cilin shqiptarët dinin shumë pak. Për Stavro Skëndin, shqiptarët që nuk patën trashëguar “lavdinë që kish Greqia” ose shkëlqimin e mbretërive mesjetare të serbëve dhe të bullgarëve, shihnin te Skënderbeu heroin e tyre të përbashkët kombëtar.¹⁸ Myslimanët duke përdorur emrin Skënderbe,

¹⁷ Ismail Qemali (*Përmbledhje dokumentesh (1888-1919)*), përgatitur për botim nga Teuta Hoxha, Drejtorja e Përgjithshme e Arkivave të Shtetit, Tiranë: 8 Nëntori, 1982, f. 232.

¹⁸ Stavro Skëndi, *Zgjimi kombëtar shqiptar, 1878-1912*, Tiranë: Phoenic & Shtëpia e Librit dhe Komunikimit, 2000, f. 425.

harronin që ai kishte luftuar kundër turqve si një i krishterë. Atyre u mjaftonte të dinin se Skënderbeu qe shqiptar prej gjaku dhe se kishte mbrojtur atdheun. Emri i tij gjithashtu, vijonte Skëndo, ndihmonte për ta harruar fenë e origjinës, mbasi ai njihej jo me emrin e krishterë Gjergj, por me emrin Skënderbeu, emër i qartë mysliman.

Pjesë bazike e diskursit të Qeverisë së Përkohshme të Vlorës mbetej evidentimi i kundërshtimit që shqiptarët ndër shekuj i kishin bërë sundimit osman. Në dallim nga ligjërimi i jashtëm, këtu nuk ngurrohej të përdorej figura e Skënderbeut, me theks të fortë në paraqitjen e aspektit luftarak, duke anashkaluar përtej realitetit historik, karakterin negociues apo diplomatik të veprimtarisë së tij. Mendojmë se mitizimi i aspektit luftarak bëhej në funksion të përçimit të mesazhit se shqiptarët nuk e kishin dhuratë shtetin e tyre, ata e meritonin sepse kishin luftuar dhe derdhur gjak për të. Në përligje të këtij konstatimi sjellim në vëmendje fjalët e Kostë Çekrezit, sipas të cilit Shqipëria “morri vendin që i kish parëshikuarë me gjakun e tij të shtrejtë dhe të shenjtë përpara pesëqind vjet në fushat e luftës, Mbret i saj i çkëlqyer”.¹⁹

Nënvizimi i luftërave të Skënderbeut, krahas rezistencës së shqiptarëve, përçonte edhe karakterin e mbrojtjes së Evropës dhe qytetërimit evropian nga “turqit barbarë”, çka si rrjedhojë nënkuptonte se shqiptarët e meritonin, më shumë se kushdo tjetër për të qenë pjesë e familjes evropiane. Në kuadrin e një vetëmburrjeje kombëtare, metaforikisht Skënderbeu cilësohej si “burri i dheut”, “mbrojtësi i vlerë”, “i pa-vdekuri trimi kombëtar..., që për shumë kohë, pengoj të vajturit përpara të Asianëve pushtues që erthnë të shuajnë dritat qytetënore të Evropës...”.²⁰

Njëkohësisht ai ishte “mbreti” që kishte lëshuar “shtizat e ziarrta, shtizat e flakta e të arta mbi Shqipëniën, shtizat e liriës, të qytetërimit e të arësimit Evropian”.²¹ Në funksion të transmetimit të aftësive shtetformuese, Skënderbeu ishte sovrani i dikurshëm i shqiptarëve, përçuesi i qytetërimit evropian dhe njëkohësisht përcaktuesi i vendit të tyre në Evropë. “Shqipëria u zgjua [zgjua], - shprehej Kostë Çekrezi, - dhe morri vendin e saj që meritonte në rreshtën e Shtetëve Evropiane”.²²

¹⁹ Kostë Çekrezi, “Shpresë, punë, Bashkim!”, në *Përlindja e Shqipëniës*, Vlorë, 20 gusht 1913, f. 1-2.

²⁰ *Po aty*.

²¹ Beri, “Kufiët e Shqipëriës. Shqipëria e lirë”, në *po aty* Vlorë, 16 gusht 1913, f. 2.

²² Kostë Çekrezi, “Shpresë, punë, Bashkim!”, në *po aty*, Vlorë, 20 gusht 1913, f. 2.

Në vijim, Skënderbeu përcaktohej si “Ati i Kombit”, krijuesi me tipare hyjnore që “vëzhgon për së lartri fatin e Shqipniës s’ onë ...” emri i të cilit do të lavdërohej përjetë dhe puna e tij do të ishte për shqiptarët shembulli i gjallë për mbrojtjen e Atdheut të tyre të shtrenjtë.²³

Në një mënyrë të përgjithshme, Gjergj Kastrioti-Skënderbeu në diskursin e kryetarit të Qeverisë së Përkohshme shqiptare, Ismail Qemal Vlorës u identifikua me simbolin e lavdisë, të sovranitetit të dikurshëm dhe të ardhshëm të kombit shqiptar. Në kuadrin shtetformues, si figurë qendrore e nacionalizmit shqiptar, Skënderbeu mishëroi bashkimin përmes sakrificës, guximin, trimërinë, luftën për lirinë e Shqipërisë. Risjellja në vëmendje e figurës së tij skaliti në faqet e gazetës *Përlindja e Shqipëniës* dhe njëkohësisht në ndërgjegjen kombëtare të shqiptarëve figurën e Heroit Kombëtar, që pavarësisht emrit të tij mysliman, mbarthe identitetin e tyre evropian.

²³ Kostë Çekrezi, “Lotë dëshpërimi, lotë ngazëllimi”, në *po aty*, Vlorë, 15/28 Vjesht e III, 1913, f. 9.